

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-273-13

**Prishtinë
20 dhjetor 2014**

Në çështjen juridike të:

Z. G.

Beograd
Serbi

Pala ankuese

Kundër

S. S.

Fshati Repë, Komuna e Podujevës

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/156/2012 të datës 06 qershor 2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA13146), pas shqyrtimit të mbajtur më 20 dhjetor 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. **Pranohet ankesa e Z.G. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/156/2012 (lënda e regjistruar me numrin KPA13146), të datës 06 qershor 2012.**
2. **Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/156/2012 (lënda e regjistruar me numrin KPA13146), i datës 06 qershor 2012 dhe çështja kthehet në KKPK për rishqyrtim.**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 26 korrik 2006, S. J. (në tekstin e mëtejme: paraqitësja e kërkesës) ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) si anëtare e familjes së ngushtë të bartësit të së drejtës pronësore/babait të saj të ndjerë V. Đ., duke kërkuar pronësinë dhe ri-posedimin e ngastrës nr. 781 në Repë të Epërme, fleta poseduese 31, me sipërfaqe prej 0.61.07 arë në zonën kadastrale të Repës, Komuna e Podujevës.
2. Për të mbështetur kërkesën e saj, paraqitësja e kërkesës ka paraqitur në AKP dokumentet e mëposhtme :
 - Fletën poseduese nr. 31, të lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Podujevës. Sipas fletës poseduese, prona ishte e regjistruar në emër të V.Đ. në cilësinë e pronarit.
 - Certifikatën e martesës të paraqitëses së kërkesës, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil, Komuna e Podujevës, që dëshmon lidhjen familjare me babanë e saj.
 - Certifikatën e vdekjes që tregon se V. Đ. kishte vdekur me 28 dhjetor 1994.
3. Në kërkesë ceket se e drejta pronësore nuk mund të ushtrohet nga 30 dhjetori 1998 si rezultat i rrethanave në vitet 1998/1999 në Kosovë dhe se prona ishte uzurpuar nga fqinji i tyre, S. S.

4. Më 18 nëntor 2009, AKP-ja ka bërë identifikimin e pronës duke vendosur një shenjë në vendin ku ndodhej prona. Ajo ishte një kullotë në posedim të Salih Sejdiut (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në kërkesë).
5. Më 19 nëntor 2009, pala përgjegjëse, duke marrë pjesë në procedurën pranë AKP-së, ka mohuar pretendimet e paraqitëses së kërkesës
6. Për të mbështetur pretendimin e tij, pala përgjegjëse në kërkesë ka dorëzuar në AKP dokumentet në vijim:
 - Aktgjykim të plotfuqishëm C.nr.361/2008 të datës 01 dhjetor 2008, të lëshuar nga Gjykata Komunale e Podujevës nëpërmjet të të cilit Gjykata Komunale e Podujevës ia ka njohur palës përgjegjëse në kërkesë të drejtën pronësore mbi ngastrën nr. 781 me sipërfaqe prej 0.61.07 arë në zonën kadastrale të Repës, Komuna e Podujevës.
 - Aktvendim kadastral 09-01/636 të datës lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Podujevës me anë të së cilit është miratuar kërkesa e palës përgjegjëse në kërkesë për regjistrim të ngastrës së kërkuar në kadastrë. Baza e ndryshimit ishte Aktgjykimi C.nr.361/2008 i datës 01 dhjetor 2008.
 - Certifikatën e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme nr. UL-71712070-00188 të datës 15 nëntor 2010 të lëshuar nga Agjencioni Kadastral i Kosovës, Zyra Kadastrale e Komunës së Podujevës, e ndryshuar në përputhje me Aktgjykimin e lartpërmendur, e cila tregon se ngastra e kërkuar është në emër të palës përgjegjëse.
7. Më 06 qershor 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) me vendimin grupor KPCC/D/A/156/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA13146), e ka e hedhur poshtë kërkesën si ***cështje e gjykuar***.
8. Më 20 mars 2013, vendimi i është dorëzuar Zorica Grubić, të bijës së paraqitësit të kërkesës (pasi që paraqitësi i kërkesës ishte i ndjerë tani) dhe ajo ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme më 11 prill 2013 (në tekstin e mëtejme: pala ankuese). Salih Sejdiu e ka pranuar vendimin më 28 mars 2013 në cilësinë e palës përgjegjëse në ankesë dhe ai ka paraqitur përgjigje në ankesë më 30 dhjetor 2013.

Pretendimet e palëve

Pretendimet e palës ankuese

9. Z. G. e kundërshton vendimin për shkak të shkeljes së rëndë të së drejtës materiale dhe procedurale dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të fakteve.
10. Pala ankuese pretendon se procedura në Gjykatën Komunale në Podujevë ishte iniciuar në kohën kur babai i të ndjerës S. J./pala e paditur kishte vdekur dhe S. J. nuk ishte informuar rreth procedurës gjyqësore. Për herë të parë, pala ankuese ishte vë në dijeni për procedurën gjyqësore nga Sekretaria Ekzekutive e AKPsë.Me datën 13 prill 2012, pala ankuese ka paraqitur propozim për përsëritjen sipas Aktgjykimit.
11. Në propozim për përsëritje të procedurës ajo thekson se në vitin 1999 ka qenë e shpërngulur për shkak të konfiktit në Kosovë dhe se nuk ka marrë pjesë në shqyrimin gjyqësor që i ka paraprirë Aktgjykimit C.nr.361/2008 të datës 01 dhjetor 2008.Ajo thekson se vendimi i AKPsë është marrë pa e shqyrtuar propozimin për përsëritje të procedurës i cili ishte paraqitur në gjykatën kompetente dhe i cili ende është në pritje në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës. Prandaj, nuk ka bazë ligjore në bazë të së cilës AKP-ja e ka interpretuar kërkesën ashtu sic është vendosur-***cështje e gjykuar*** duke iu referuar procedurës gjyqësore në Gjykatën Komunale të Podujevës.
12. Pala ankuese ka paraqitur prova shtesë duke pohuar se ato nuk ishin dorëzuar në KKPK për shkak se nuk ishin kërkuar nga zyrtarët e AKP-së.
 - Deklaratën Ov.I.nr.64523/2013 të datës 10 prill 2013 të lëshuar nga Gjykata e Parë Themelore e Beogradit me anë të së cilës pala ankuese merr përsipër dhe vazhdon me procedurën administrative si pasardhës ligjor i të ndjerës S. J. e cila kishte vdekur më 14 mars 2011 në Beograd.
 - Propozimin për përsëritjen e procedurës P. nr. 361/2008 të datës 14 mars 2012 të paraqitur nga pala ankuese në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës nëpërmjet Gjykatës Komunale të Podujevës për shkak të pamundësisë së palës së paditur që të kundërshtoj pretendimit e palës paditëse dhe që të dëgjohet si palë në mënyrë të duhur dhe të paanshme.
 - Urgjencën P. nr. 361/2008 të datës 13 mars 2013 të paraqitur nga pala ankuese në Gjykatën e Apelit të Kosovës ku ka kërkuar që të informohet në lidhje me statusin e kërkesës dhe të ndërmerren veprimet e nevojshme faktike dhe ligjore.

Pretendimet e palës përgjegjëse në kërkesë/Ankesë

13. Pala përgjegjëse në ankesë është përgjigjur në ankesë duke pretenduar se procedura në Gjykatën Komunale në Podujevë ishte zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore. Ai ka deklaruar se babai i tij S. S. e kishte blerë ngastrën e kërkuar nga V. Đ. në vitin 1993. Kontrata e shitblerjes ishte përpiluar, çmimi i dakorduar ishte paguar dhe S. S. e kishte marrë pronën e kërkuar në posedim që nga ajo kohë, por në vitin 1994, për shkak të një konflikti ndërmjet V. Đ., S.S. dhe palës përgjegjëse në ankesë, ky i fundit ishte arrestuar dhe kontrata e shitblerjes ishte konfiskuar nga policia dhe asnjëherë nuk i ishte kthyer atij. Pasi që V. Đ. kishte shkuar në Serbi dhe nuk kishte ardhur për të bërë bartjen e titullarit të pronësisë në emër të blerësit, S. S. e kishte iniciuar procedurën gjyqësore në Gjykatën Komunale të Podujevës, e cila duke vepruar në përputhje me procedurat ligjore e kishte përmbyllur rastin, që u vendos si ***cështje e gjykuar***.

Arsyetim ligjor:*Pranueshmëria e ankesës*

14. Ankesa është e pranueshme pasi që ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve të paraparë me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079.
15. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë të zgjidhë kërkesat që ndërlidhen me konfliktin e që kanë të bëjnë me pronësinë apo të drejtat pronësore mbi pronë e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale. KKPK-ja është kompetent vetëm nëse këto kërkesa ndërlidhen drejtpërsëdrejti ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
16. Pala ankuese pretendon ta ketë humbur posedimin e ngastrës së kërkuar më 30 dhjetor 1998 si rezultat i rrethanave në vitet 1998/1999 në Kosovë dhe se e njëjta ishte uzurpuar nga pala përgjegjëse në ankesë.
17. Në rastin aktual, ishte vërtetuar se pala përgjegjëse në ankesë është regjistruar si bartës i së drejtës pronësore mbi ngastrën e kërkuar sipas një aktgjykimi të plotfuqishëm të vitit 2008, me anë të së cilit pretendimet e palës përgjegjëse në ankesë ishin konfirmuar në baze të tre

- dëshmitarëve, ku më këtë rast është konstatuar se babai i palës përgjegjëse në ankesë e kishte blerë ngastrën e kërkuar në vitin 1993 dhe se çmimi i blerjes ishte paguar në tërësi. Për më tepër, gjykata ka gjetur se pala përgjegjëse në ankesë e kishte në posedim të papenguar pronën në fjalë që nga koha kur e kishte blerë atë.
18. Pala ankuese si palë e paditur ishte i përfaqësuar nga një përfaqësues i përkohshëm i caktuar nga gjykata në përputhje me nenin 79.3 (a), (b) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Nr.03/L-006). Gjykata Komunale e Podujevës kishte vendosur për të drejtën pronësore mbi të njëjtën pronë me të njëjtat palë ndërgjyqësore sikurse në lëndën aktuale.
19. Megjithatë, kërkesëpadia ishte parashtruar pas hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/500. Gjykata Komunale e Podujevës ka vendosur në këtë çështje ndonëse ajo nuk ishte në kuadër juridiksionit të saj. Neni 18, paragrafi 1 në bashkëveprim me ninin 18, paragrafin 2 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore parasheh se gjykata duhet që sipas detyrës zyrtare të kujdeset gjatë tërë procedurës nëse zgjidhja e kontestit është ose jo në kuadër të juridiksionit të gjykatës. Kur gjykata gjatë procedimit të çështjes konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata veçse ndonjë organ shtetëror tjetër, do të shpallet inkompetente, do të shpallë të pavlefshme të gjitha veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që i është paraqitur.
20. Neni 18 i Ligjit 03/L-079, përjashton juridiksionin e gjykatave të rregullta për paditë sipas nenit 3.1 *ibid*, nëse procedura në lidhje me padinë e këtillë nuk ka filluar para datës së hyrjes në fuqi të ligjit. Ligji 03/L-079 (më parë Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50) ka hyrë në fuqi më 16 tetor 2006. Prandaj, gjykata Komunale në Podujevë nuk ka pasur juridiksion pas kësaj date për të vendosur për kontestet pronësore që ndërlidhen apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur i viteve 1998/1999.
21. Duke qenë se vendimi i ankimuar është marrë me shkelje thelbësore nga neni 182 paragrafi 2 nën paragrafi (b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ngase me vendimin e theksuar të KKPksë është vendosur për çështjen që i referohet sikundër juridiksionit të Komisionit ashtu edhe të panelit të Apelit të parashtruar sipas nenit 18 të Ligji nr. 03/L-079, prandaj ky vendim anulohet dhe i kthehet komisionit për rishqyrtim.

22. Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se është e domosdoshme të sigurohen nga KKKPKja prova relevante lidhur me vendimmarrjen sipas propozimit për përsëritjen e procedurës në Gjykatën Komunale të Podujevës dhe Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Pas administrimit të këtyre provave të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Këshillë juridike

23. Në përputhje me nenin 13,6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it